



Informacione mbi shkollën

Për prindërit e fëmijëve të porsaardhur

Përshëndetje

Ne gëzohemi, që fëmija Juaj vjen në klasë tek ne. Për t'juja lehtësuar fillimin e shkollës, ne kemi përmbledhur shkurtimisht informacionet më kryesore. Ne shpresojmë në një bashkëpunim të mbarë dhe jemi me kënaqësi, gati për biseda të mëtejshme. Ne i urojmë fëmijës tuaj një periudhë të mbarë shkollë dhe jemi besimplotë, që ai do të ndihet mirë tek ne.

Mësues-i/ ja i/e klasës:

Klasa fillestare pranuese (më parë klasa e vogël E) mësimi fillestar

Klasa fillestare pranuese është një klasë për 10-14 fëmijë, të cilët nuk dinë akoma gjermanisht. Ato mësojnë të njëjtat lëndë si në klasën normale. Përparësi kryesore i jepet të mësuarit e gjuhës gjermane. Njëkohësisht fëmijët njihen me të përditshmen e shkollës në Zvicër. Së shumti pas një viti bëhet kalimi në një klasë normale në shkollën e lagjes. Kjo është e mundur edhe gjatë vitit shkollor.

Në klasën fillestare pranuese me mësim të përkohshëm, fëmijët frekuentojnë disa lëndë për në klasën normale të ardhshme. Ato mësojnë gjermanisht intensivisht në klasën fillestare pranuese ose në mësimin fillestar. Numri i orëve në klasën normale rritet vazhdimisht. Më së shumti pas 2-3 vjetësh, përfundon kalimi në klasën normale.

Sistemi shkollor

Kopshti për fëmijë: i detyrueshëm	2 vjet
Shkolla fillore: e detyrueshme	6 vjet
Niveli fillestar:	klasa 1.-3.
Niveli i mesëm:	klasa 4.-6.
Kalimi: Caktimi sipas një vlerësimi të përgjithshëm dhe rekomandimi të mësuesit, bisedë me prindërit (për gjimnaz, provim pranimi)	
Cikli i lartë: i detyrueshëm (Klasa me kërkesa të ndryshme)	3 vjet
Shkolla profesionale: ose	2-6 vjet
Shkolla e mesme (Gjimnazi):	4-6 vjet

Krahas kësaj ekziston edhe një sistem përkrahje, në të cilin mësues me arsim të posacëm, mësojnë fëmijët me nevoja të veçanta.

Dëftesat dhe notat

Në klasën fillestare pranuese nuk ka vlerësim me nota. Ndekja e shkollës vertetohet në dëftesë. Me prindërit zhvillohen biseda. Në klasën fillestare të përkohshme dhe në mësimin fillestar, mund të jepen nota në dëftesë, përveç se në gjermanisht. Çdo fëmijë merr 2 herë në vit një dëftesë (para pushimeve sportive dhe atyre verore). Shkalla e notave: 1-6 (1 shumë dobët, 2 dobët, 3 jo mjaftueshëm, 4 mjaftueshëm, 5 mirë, 6 shumë mirë). Në vlerësim mund të jepen edhe gjysëmnota (P.sh.: 4-5, 5-6 etj.). Veç kësaj, vlerësohet edhe sjellja në punë, mësim dhe sjellja sociale. Në klasën e parë nuk ka nota, por dy biseda prindërore me vërtetim në dëftese.

Mungesa në shkollë, kërkesa për pushim, ditët e festave fetare

Kur fëmija mungon në shkollë, ai duhet të çrregjistrohet. Kërkesat për pushime më shumë se dy ditë duhet ti drejtohen organit përgjegjës të shkollës. Në ditë të rëndësishme festash fetare, jepet pushim sipas kërkesës.

Asnjë shpenzim për pindërit

Ndjekja e shkollës si dhe materiali shkollor janë falas. Një pjesë e mirë e librave duhet të kthehen përsëri mbrapsht, pjesa tjetër mund të mbahet.

Plani i orëve (shih shtojcën)

Shkolla funksionon sipas një plani orësh të caktuar. Është me rëndësi, që fëmija Juaj të shfaqet i përpiktë në mësim.

Në katër ditë (të hënë, të martë, të enjte, të premte) mësimi zhvillohet paradite dhe mbasdite, ndërsa të mërkurave vetëm paradite. Në rast nevoje, pushimi i drekës mund të organizohet nga shkolla.

Në shkollë jepen keto lënde: Gjermanisht, anglisht (nga klasa e dytë), matematikë, njeriu dhe ambienti, sport (gjimnastike dhe not), muzikë, vizatim, punë dore dhe me vegla, frëngjisht (nga klasa e pestë), feja dhe kultura.

Për raste të veçanta si ditë sportive, ekskursione, kamping me klasë etj., lajmërohet veçmas.

Gjuha dhe kultura amtare (HSK)

Në 2-4 orët javore fakultative të mësimit shtesë, fëmijët mund të mësojnë vullnetarisht gjuhën e tyre amtare.



Sporti

Për orën e gjimnastikës fëmijëve u nevojitet një fanellë, pantallona/tuta sportive dhe këpucë gjimnastike/ose për vegla gjimnastikore, që mbahen vetëm për palestër, për not një palë mbathje banje, një peshqir dhe një kapele noti (në dimër një kapuç rrugës për në shtëpi).

Detyrat e shtëpisë

Detyra shtëpie jepen rregullisht, që fëmija duhet ti zgjidhë me kujdes dhe në mënyrë të pavarur. Luten prindërit, që të kujdesen për atë, që fëmija të punojë detyrat e shtëpisë rregullisht dhe në qetësi.

Takimet, bashkëpunimi i mësuesit me prindin

Për prindërit ka ditë vizitash, mbrëmje prindërore, biseda individuale me qëllim që të arrihet një kontakt i ndërsjelltë. Ju lutemi ejani në shkollë nëse jeni të ftuar! Nëse keni pyetje apo nëse dëshironi një bisedë me mësuesin e fëmijës Tuaj, lini ju lutem një orar takimi. Sipas nevojës mund të kërkohet edhe një përkthyes.

Dentisti i shkollës

Dentisti i shkollës i kontrollon dhëmbët e të gjithë fëmijëve në intervale të rregullta kohore. Në shkollë fëmijët udhëzohen për një përkujdesë të mirë të dhëmbëve.

Plani i pushimeve dhe ditët e lira

(datat e sakta dhe ditët e tjera te lira- shih planin e pushimeve)

Të 13 javët e pushimeve janë ndarë gjatë gjithë vitit si vijon:

5 javë pushime vere	(Korrik, Gusht)
2 javë pushime vjeshte	(Tetor)
2 javë pushime Krishtlindjeje	(fund Dhjetori)
2 javë pushime sportive	(Shkurt)
2 javë pushime pranverore	(Prill)

Cyrih, dhjetor 2007 (përmbledhje e përpunuar)

Botues: mësuesit e klasës së vogël E dhe drejtorja arsimore

Autorët: Daniela Beyer, Carolina Luisio, Karin Then, Markus Truniger (Redakcion)

Strukturimi: Danielle Ferraro